

Të Njohësh Tjetrin

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Vetbesimi, Mirëkuptimi, Respekti, Siguria, Vetvlerësimi

Qëllimet

Pedagogjike: Të kuptosh realitetin dhe të masësh rrjedhojat e një sekreti. Zhvillimi i aftësisë për të menaxhuar konfliktet dhe për të kërkuar ndihmë.

Praktike: Leximi i historisë dhe eksplorimi i dilemave me të cilat përballen personazhet.

Pjesëmarrësit

Minimumi 6;
Maksimumi 30

Kohëzgjatja

45 deri 60 minuta

Materialet

Fleta e aktivitetit që mund të projektohet ose të printohet dhe tu shpërndahet nxënësve.

Përmbledhje

Mësuesi/ja projekton ose i shpërndan fletën e aktivitetit secilit nxënës. Në grupe dyshe, nxënësit duhet të lexojnë me kujdes ngjarjen dhe t'u përgjigjen pyetjeve. Secili grup ia prezanton përgjigjet klasës, ndërsa mësuesi/ja mban shënim përfundimet kryesore në tabelë. Në fund, mësuesi identifikon zgjidhjen që është sugjeruar më shumë nga nxënësit, duke eksploruar arsyetimin për këtë zgjidhje.

Shënime

Mësuesi/ja mund të sugjerojë dy nxënës për ta interpretuar ngjarjen, në vend të leximit.

Për informacione shtesë në lidhje me sigurinë e internetit, rekomandohet të vizitoni faqen e internetit:

<http://www.safekids.com/>



Të Njohësh Tjetrin

Fleta e Mësuesit (vazhdim)

Diskutimi

Për të orientuar diskutimin, mësuesi mund të eksplorojë pyetjet e mëposhtme me klasën:

Si e interpretoni sjelljen e Françeskos? A mendoni se Françesko do të kishte të njëjtën sjellje nëse do të kishte folur personalisht me Marianën?

Sipas mendimit tuaj, çfarë janë grabitqarët online? Si veprojnë ata?

Me çfarë rreziqesh mund të përballeni nëse flisni me të huaj në internet, edhe në rastet kur e dini emrin e tyre?

Me çfarë rreziqesh mund të përballeni nëse pranoni të takoheni me dikë që e keni njohur në internet?

Mendoni se njerëzit sillen ndryshe në internet? Pse?

Bisedoni shpesh online (chat)? Flisni me të huaj zakonisht në internet?

Jeni ndjerë ndonjëherë të parespektuar kur keni biseduar me dikë online?

Nëse po, ia treguat ndonjërit atë situatë? Pse?

Njihni ndonjë që ka qenë viktimë e keqpërdorimit të internetit? Nëse po, çfarë ndodhi? Pse?



Të Njohësh Tjetrin

Fleta e nxënësit

Ngjarja

Klik. Ja ku ishte shenja që tregonte se Françesko ishte online. Mariana mezi po priste. Ai i thoshte gjëra shumë të bukura ... është e vërtetë që ajo nuk e njihte personalisht, por ai duhet të ishte një djalë shumë i mirë. Ajo tashmë ishte mësuar të ndante me të idetë, shijet dhe problemet e saj....

Mariana ishte zemëruar me mamanë e saj, sepse e kishte qortuar pasi nuk hante si duhet. Mariana vendosi të ndante me Françeskon debatin që kishte patur me nëmamanë e saj: - Do të ndjehem më mirë, - mendoi ajo.

Ndërsa Mariana ishte duke pritur me padurim një përgjigje nga Françesko, vuri re se nëna e saj po qëndronte në cep të dhomës, në heshtje. Françesko e ftoi atë që të shkonin bashkë në kinema, dhe i tha që të mos tregonte në shtëpi. Ai dëshironte që ajo të shkonte vetëm me të. Mariana u zhyt në mendime me përgjigjen e tij dhe po shihte mamanë e saj duke pyetur veten.

Françesko nuk e komentoi fare zënkën që ajo kishte pasur me nënën e saj dhe në vend të kësaj shkruante për shakatë me shokët e tij të shkollës duke këmbëngulur që të shkojnë në kinema. Françesko tregohet i paduruar ndaj heshtjes së Marianës, e cila nga ana e saj u habit me sjelljen e tij.

1. Sipas mendimit tuaj, çfarë është e drejtë, e gabuar dhe as e drejtë as e gabuar në këtë histori? Argumentoni përgjigjet tuaja.

Është e drejtë _____
sepse _____

Është e gabuar _____
sepse _____

Nuk është as e drejtë as e gabuar _____
sepse _____

2. Identifikoni në këtë histori, episodet, dilemat dhe gjendjen shpirtërore të personazheve duke iu referuar?

Përrjashtimi kundrejt Ndarjes _____

Pranimi kundrejt Miqësisë _____

Siguria kundrejt Pasigurisë _____



